



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta Ministry of Culture, Youth & Sports
Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale
Agencija za Upravljanje Spomenika i Memorijalnih Kompleksa
Agency for the Management of Monuments and Memorial Complexes

AGJENCIA PËR MENAXHIMIN E MONUMENTEVE DHE KOMPLEKSEVE MEMORIALE
REPUBLIC OF KOSOVO
AGENCIJA ZA UPRAVLJANJE SPOMENIKA I MEMORIJALNIH KOMPLEKSA
AGENCY FOR THE MANAGEMENT OF MONUMENTS AND MEMORIAL COMPLEXES
01 Shënja klas. 103
6.11.2025
09.01.2025
Prishtine

DATË/DATUM/DATE	09.01.2025
PËR/ZA/TO:	Z. Hajrulla Çeku , Ministër në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
CC:	Z. Bislim Bislimi , Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Znj. Nora Arapi , Këshilltare e Ministrit, Kabineti i Ministrit
NGA/OD/FROM:	Imer Hakaj , Drejtor Ekzekutiv i Agjencisë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale/AMMKM
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport i punës së Agjencisë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale për vitin 2024

I nderuar ministër Çeku,

Duke shprehur falenderimin dhe mirënjohje për mbështetjen e vazhdueshme në realizimin e projekteve dhe punëve në AMMKM, në vijim gjeni Raportin e punës të Agjencisë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale i cili përfshinë të dhënat për realizimin e buxhetit dhe projektet kapitale për vitin 2024.

Tabela nr. 1. Shpenzimi i Buxhetit 2024

Kategoria Ekonomike	Buxheti fillestar	Buxheti final	Të shpenzuara	% e realizuar
Paga dhe mëditje	204,168.00	175,567.99	175,567.99	100%
Mallra dhe shërbime	640,000.00	890,500.00	824,967.68	93%
Shpenzime komunale	63,000.00	79,500.00	65,611.75	83%
Kapitale	5,390,000.00 (totali) 3,190,000.00	3,651,559.00	2,351,992.85	64.4%
Grant i donatorëve të brendshëm	5,000.00	5,000.00	0	0
Kompleksi Memorial Adem Jashari Prekaz	2,000,000.00	1,000,000.00	0	Procedura e tenderimit e zhvilluar nga MKRS. Buxheti konsiderohet i realizuar pasi që mjetet janë të kontraktuara.
Totali Përqindja e llogaritur me buxhet të kontraktuar nga Kompleksi Memorial Adem Jashari	6,297,168.00	4,797,126.99	3,418,140.27	71.2%
Totali:	6,297,168.00 (totali) 4,097,168.00	4,797,126.99 (totali) 3,797,126.99	3,418,140.27	90%

Sqarim: Projekti Kompleksi Memorial “Adem Jashari”, Prekaz, ka pasur vlerën 2,000,000.00€ dhe AMMKM ka qenë përgjegjëse vetëm për realizim të buxhetit, jo procedurën dhe nuk është varur nga AMMKM vonesat në realizim të buxhetit. Prandaj shuma e projekteve në tabelë janë

paraqitur totali si buxhet dhe pa shumën e projektit të Kompleksit Memorial “Adem Jashari”. Me Vendim të Qeverisë Nr. 03/239 të datës 24.12.2024, për këtë projekt, janë marr mjetet për kursim me vlerë prej 1,000,000.00€.

Projektet kapitale në proces të realizimit për gjatë viteve 2022, 2023 dhe 2024

Konservimi dhe Ndertimi i Kompleksit Memorial-Historik-Shtabi i ZOD-it të UÇK-së dhe Muzeut në Glllogjan, Faza III buxheti i përgjithshëm i planifikuar për realizimin e kësaj kontrate është 2,314,764.00€, realizimi është në shumë prej 1,351,698.02€;

Projektet kapitale në proces të realizimit për gjatë viteve 2023, 2024 dhe 2025

- Projekti me titull “Ndërtimi i “Memorialit të Martirëve në Çikatovë të Re ” – Drenas Ritender Çikatovë e Re”; (2023,e paraparë 2025,e përfunduar 2024)
- Projekti me titull “Renovimi i Memorialit të Dëshmorëve dhe Martireve në Grabanicë, Klinë”; (2023, e paraparë 2025, e përfunduar 2024)
- Projekti me titull “Ndërtimi i Lapidarit të Dëshmorëve të UÇK-së”, Mitrovicë; (2023, e përfunduar 2024).
- Projekti me titull “Konservimi dhe Restaurimi i Disa Objekteve të Luftës së UÇK - së dhe Objekteve ku Janë Kryer Masakrat”; (2023-2024) (Konservimi dhe Restaurimi i Xhamisë së Brojë-Skenderaj (e përfunduar 2024), Konservimi dhe Restaurimi i Shtëpisë së Familjes Lipa Studenicë – Istog (është e anuluar si projekt me kërkesë të familjes), Konservimi dhe Restaurimi i Shtëpisë së Familjes Gërxhaliu Vushtrri (është anuluar si projekt me kërkesë të familjes), Konservimi dhe Restaurimi i Shpellës ku ka Shërbyer si Spital i UÇK-së Petrovë-Shtime, Trajtimi i Gjashtë Lisave në Likoshan, Konservimi dhe Restaurimi i Mullirit I në Lladroc- Malishevë dhe Konservimi dhe Restaurimi i Mullirit II në Lladroc, Malishevë (e përfunduar 2024))
- Projekti me titull “Vendosja e Pllakave Informuese ne Komplekse dhe Memoriale për Nevojat e AMMKM-së Faza e -I-“; (2023,e përfunduar 2024)
- Projekti me titull “Ndërtimi i Shtatorës së Dëshmorit “Rifat Mziut” Marinë – Skenderaj – Ritender”; (2023-2024 shtatorja ka përfunduar,ndërsa vendosja e saj është mbetur të caktohet lokacioni nga komuna)

- Projekti me titull “Ndërtimin e Varrezave të Veteranëve në K.M në Kleçkë (K.M “ZIV Shtabi i Përgjithshëm Kleçkë dhe Divjakë” Malet e Berishës”. (2023, e përfunduar 2024)
- Projekti me titull “Konservimi i Shtëpisë ku është kryer Masakra në Poklek të Vjetër Drenas-Muzealizimi” në vlerë prej 117,887.88 euro. (2023, e përfunduar 2024).

Projektet kapitale të realizuara dhe në proces të realizimit për gjatë vitit 2024

- Projekti me titull “Ndërtimi - Muzealizimi i Memorialit të Dëshmorëve të UÇK-së në Penuhë - Komuna Podujevë” në vlerë prej 98,499.13€; (2024, e përfunduar 2024)
- Projekti me titull “Intervenim Emergjent në Projektin e Memorialit të Dëshmorëve të UÇK-së, Ngucat Malishevë” në vlerë prej 5,937.16 €; (2024, e përfunduar 2024)
- Projekti me titull “Zhvarrosja dhe Rivarrosja e Heronjve, Dëshmorëve, Martirëve dhe Veteranëve në Komplekset Memoriale dhe Varrezat e Dëshmorëve dhe Martirëve” në vlerë prej 170,000.00€; (Kontrata është nënshkruar nga AMMKM-ja me datë 04.12.2024)
- Projekti me titull “Ndërtimi-Ekzekutimi i Punimeve në Kompleksin Memorial të Dëshmorëve të UÇK - së në Marinë, Skenderaj - faza -II- në vazhdim” në vlerë prej 99,636.42€; (2024, e përfunduar 2024)
- Projekti me titull “Ndërtimi i Memorialit të Dëshmorëve të Brigadës 136 Rugova në Pepaj - Rugovë” në vlerë prej 100,000.00€ (60,000.00€ për vitin 2024 dhe 40,000.00€ për vitin 2025); (në proces të punimeve)
- Ndërhyrjet emergjente në Kompleksin Memorial “Beteja e Koshares” , Koshare me vlerë 8,160.00 (2024, e përfunduar 2024)
- Ndërtimi i shtatoreve të vëllëzerve Gërvalla dhe Kadri Zekës – Ferizaj; (është hartuar projekti dhe nga AMMKM është dorëzuar projekti në MKRS).
- Ndërtimi i Memorialit të dëshmorëve dhe martirëve në Terstenik- Drenas, faza e II-të në vlerë prej 49,887.20 (në proces të punimeve)
- Projekti me titull ”Kulla e Heroit “Fehmi Lladrovci” Drenas, është nënshkruar me datë 27.11.2024 me vlerë 271,984.70, është në koordinim me Komunën e Drenasit për realizimin e këtij projekti; (në proces të fillimit të punimeve).

AMMKM-ja lidhur me shpronësimet këtë vitë 2024 ka iniciuar procedurat dhe ka bërë plotësimin e elaboreteve ekzistuese me të dhëna dhe dokumentacione shtesë, si për:

I. Komplekse Memoriale të cilat janë në proces të Shpronësimit

1. Zona e Intersit te Veçantë “Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së Kleçkë dhe Divjakë– Malet e Berishës”.

Brenda kësaj ZIV - i, gjenden këto hapësira për tu shpronësuar: Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së – Divjakë, Shtabi i UÇK-së, “Brigada 121” dhe “Pushimorja e Fëmijëve” - Kleçkë;, Objektet ku ishin “Spitalet e UÇK-së”, Shtabi i “Komandant Kumanova” – Luzhnicë, Qendra protokollare, Shtëpia “Radio Kosova e Lirë”, Bunkeri i “Radio Kosova e Lirë; (këtu veç është zgjidhë pronësia përmes, Agjencisë për Pyjet e Kosovës).

Ndërsa për fazë dytë mbetën për shpronësim: Fshati i UÇK-së, Shtëpia e Delegacionit të Rambujesë - Qeveria e Përkohshme në Novosellë, Mulliri i UÇK-së.

K.M “ Shtabi i ZOD Glllogjan”, Deçan; Është bërë plotësimi i elaboreteve ekzistuese me të dhëna dhe dokumentacione shtesë.

2. Memoriali “Masakra e Likoshanit” Likoshan - Drenas; Është bërë plotësimi i elaboreteve ekzistuese me të dhëna dhe dokumentacione shtesë

3. Shtëpia “Familjes Muqolli, ku është kryer Masakra në Pollek të Vjetër” - Drenas; Është bërë plotësimi i elaboreteve ekzistuese me të dhëna dhe dokumentacione shtesë

4. K M “Dëshmorët e Kombit” Vrellë Istog; Është bërë plotësimi i elaboreteve ekzistuese me të dhëna dhe dokumentacione shtesë.

II. Komplekse Memorialë për të cilat ka përfunduar procesi i Vendimeve:

1. KM “Masakra e Raçakut Raçak Shtime:

Pasi këtë vit Qeveria e Republikës së Kosovës ka nxjerre Vendimin Final; Nr. 13/226 të datë: 23.10.2024. pronat dhe Shtëpitë ku janë kryer masakrat, janë në proces të pagesave të shpronësimit. Pagesat një pjesë e shpronësimit kryhet këtë vit 2024 dhe pjesa tjetër do të kryhen vitin 2025.

2. Memoriali “Kulla e Demë Ahmetit “ Reçicë - Podujevë: Qeveria ka nxjerrë vendimin final për shpronësim, Vendimi: Nr.08/101, të datë: 02.05.2019.

III. Memorialët që duhet të hynë në procesin e Shpronësimit:

1. Konservimi dhe Restaurimi i Shtëpisë ku është Kryer Masakra e Familjes Lipaj dhe Zeqiraj, Studenicë - Istog.

Tabela nr. 2. Shpenzimet në kategorinë investime kapitale 2024

Kodi i Projektit	Emri i Projektit	Vlera e shpenzuar
14362	Vazhdimi i punimeve në Kompleksin Memorial Beteja e Koshares	8, 160.00
14363	Memoriali i dëshmorëve të UÇK-së në Penuhë	98,499.13
14647	Kompleksi Memorial “Varrezat e dëshmorëve të UÇK-së” Marinë	99,636.42
14649	Kompleksi Memorial ZIV “Shtabi i përgjithshëm i UÇK-së” Kleçkë	64,609.55
14650	Kompleksi Mem.Ish Pres. “Dr.Ibrahim Rugova” Velani Prishtinë	49,347.50
14652	Kompleksi Memorial “Shtabi i Pergjithshem i UÇK-së” ZOD	657,593.53
14657	Projekti per Intervenime Emergjente në Komplekse Memoriale	233,881.16
15044	Memoriale Mejë-Gjakovë	19,988.46
18299	Konzervimi i Shtëpisë ku është kryer masakra në Poklek të vjetër	49,959.30
18534	Ngritja e Pllakës Përkujtimore për daljen e parë publike të UÇK-së-Llaushë	27,567.00
18693	Renovimi i Lapidareve dhe varrezave të dëshmorëve në komunën e Suharekës	50,000.00
18679	Konservimi dhe restaurimi i disa objekteve të luftës së UÇK-së	5,483.15
18931	Memoriali “Ekzodi i Bllaces 99” Hani i Elezit	9,103.00
18934	Vendosja e Pllakave Informuese në Komplekse dhe Memoriale të Kosovës	37,765.00
18958	Memoriali Varrezat e Deshmoreve të UÇK-së	44,602.20

Trestenik-Drenas		
19109	Memoriali i Martirëve Çikatovë e Re-Drenas	123,033.64
19110	Shtëpia Shtabi i UÇK-së Zhjegovc Gjilan	39,484.40
19116	Ndërtimi i Varrezave të Dëshmorëve në Grabanicë Klinë	349,234.41
19178	Shtatorja e Rifat Mziut -Skenderaj	60,000.00
19180	Ndërtimi i Lapidarit të Dëshmorëve të UÇK-së Mitrovicë	4,990.00
14645	Kompleksi Memorial "Masakra e Raçakut" Raçak -Shtime (Shpronësim)	304,,000.00
19181	Ndërtimi i Memorialit të dëshmorëve të Brigadës 136 Rugova	15,055.00
Totali		2,351,992.85

Për vitin 2024 AMMKM-së, nga kategoria mallra e shërbime dhe shpenzime komunale me buxhet i janë ndarë mjete më pak kundrejt obligimeve të kontraktuara. Pas përfundimit të projekteve kapitale, përkatësisht investimeve në komplekse dhe memoriale, është rritur kostoja e mirëmbajtjes së tyre, gjithashtu janë rritur edhe shpenzimet komunale në komplekse memoriale. Aktualisht AMMKM mirëmban më shumë se 30 komplekse, memoriale dhe objekte tjera. Me buxhetin e aprovuar obligimet e krijuara si në mirëmbajtje po ashtu shpenzime komunale nuk kanë mundur të mbulohen deri në fund të vitit 2024.

Kërkesat për transfer/rialokim është bërë nga projektet:

14363 Memoriali i Dëshmorëve të UÇK-së, në Penuhë: -1,500.00€.

14649 K.M ZIV Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, Kleçkë dhe Divjakë: - 188,500.00€.

18679 Konservimi dhe restaurimi i disa objekteve të luftës së UÇK-së: -22,000.00€

19107 Memoriali i Masakrës së Vërbovcit, - 55,000.00€.

Janë rialokuar/transferuar në:

13 - Mallra e shërbime: + 250,500.00€

14 - Shpenzime komunale: + 16,500.00€

Shuma totale e transfereve/rialokimeve është 267,000.00€.

Stafi / rekrutimi

Sipas Ligjit nr. 08/L-260 për buxhetin e vitit 2024, AMMKM ka 22 pozita, prej tyre aktualisht ka 19 pozita të plotësuara dhe tre pozita të lira.

Projektet të cilat janë në buxhet për vitin 2024 për të cilat AMMKM kushtëzohet për realizim nga institucionet e tjera kompetente:

1. Projekti me titull “Kompleksi Memorial “Demë Ahmeti”, Podujevë, i cili nuk është realizuar për shkak që për këtë projekt është në vazhdim procesi gjyqësor;
2. Projekti me titull “Rregullimi dhe mirëmbajtja e sheshit “Adem Jashari” në Malishevë” në koordinim me Komunën e Malishevës për realizimin e këtij projekti;-
3. Projekti me titull “Kompleksi Memorial “Masakra e Krushes së Vogël” Prizren. Komuna e Prizrenit ka përfunduar një fazë të projektit, ndërsa për realizimin e fazës së dytë janë shfaqur probleme nga familjarët e të rënëve.
4. Projekti me titull “Ndërtimi i Shtatores së Dëshmorit “Rifat Mziut” Marinë – Skenderaj – Ritender”.Shtatorja ka përfunduar, ndërsa për vendosjen e saj është mbetur të caktohet lokacioni nga Komuna.